



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 13.7 dhe 14.7, lidhur me nenin 16.2, dhe nenin 19.2 e 33 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, të dt. 3.7.2003, të shpallur sipas Rregullores nr.2003/30, të dt.10.9.2003; të nenit 3, par.1, pika b, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b dhe të nenit 40, par. 3, pika II të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2007, merr

## **V E N D I M**

### **PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË PROPOZIMPLANIT RREGULLUES PËR LAGJEN “LAKËRISHTA” NË PRISHTINË**

#### **Neni 1**

Miratohet Vendimi për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues për lagjen “Lakërishta” në Prishtinë. Propozimplanin, nga paragrafi 1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

#### **Neni 2**

Shqyrtimi publik i Propozimplanit rregullues, sipas këtij Vendimi, zgjat 30 ditë, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Organizimin e shqyrtimit publik të Propozimplanit, sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 3**

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të Propozimplanit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë, do të kryejë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij plani, në mënyrë që ai t`i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.Nr. 35-264, dt.17.05.2007**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**